



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Komuna e Prishtinës  
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



**SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT**

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1 nënparagrafi d) si dhe nenin 63 paragrafi 63.1 nënparagrafi 63.1.1 të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik “Risamont Sh.P.K.” të datës 04.09.2024 kundër njoftimit mbi vendimin e datës 30.08.2024 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “122 Ndërtimi, zgjerimi dhe modernizimi i rrjetit të ndriçimit publik” me nr. të prokurimit 616-24-3392-5-1-1, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

## V E N D I M

- I. **REFUZOHET** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik “Risamont Sh.P.K.” të datës 04.09.2024 kundër njoftimit mbi vendimin e datës 30.08.2024 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “122 Ndërtimi, zgjerimi dhe modernizimi i rrjetit të ndriçimit publik” me nr. të prokurimit 616-24-3392-5-1-1.
- II. **AUTORIZOHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit të përcaktuar si në pikën I të këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHEN** palët e interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

### Arsyetim

Operatori ekonomik “Risamont Sh.P.K.” (tutje “parashtruesi”) me datë 04.09.2024 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin e datës 30.08.2024 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “122 Ndërtimi, zgjerimi dhe modernizimi i rrjetit të ndriçimit publik” me nr. të prokurimit 616-24-3392-5-1-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimet ankimore të parashtruesit janë si vijon:

## OE i rekomanduar për Lot 2

### P1 -

Te gjeturat:

OE i propozuar per kontrate ka autorizim nga dy prodhues te ndryshem: UNICOMLITE dhe DIECASTINGMANLIGHT.

OE i propozuar per kontrate ka ofertuar me dy prodhues per pozicionet e njejta,

### P2 -

Komenti: Mostra e dorezuar nuk disponon me te dhenat bazike te prodhuesit si dhe me te dhenat tjera te cilat do duhej te ishin konform te dhenave teknike te produktit te ofertuar me katalog.

Produkti ngjason me modelin e ofertuar YASL-09, mirepo te dhenat e produkti te vendosura ne stikser me ngjites ne mostren e produktit, nuk jane te ngjashme me te dhenat e produktit ne katalog (**ne katalog parametri i tensionit AC90-305V, ndersa ne stikser AC100-277V etj**), pervec tjerash, duket se stikseri i eshte vendosur mostres me te dhena sipas kerkeses se AK, respektivisht teksti ne gjuhen angleze eshte i shkruar gabim, gje qe e verteton nje gje te tille.

Duke mare parasyshe kete, ateher produkti i ofertuar nuk ploteson parametrat e kerkuar nga AK te pershkruar ne pershkrim te cmimeve dhe te kerkuara ne FDT me deshmi dokumentare-katalog. Deshmia 2

### P3 -

Vërejtje: OE duhet ta plotësoj kolonën D me te gjitha te dhënat për pajisjet e ofruara siç është (viti I prodhimit , gjendja e pajisjes , kamiona rexhistrimi i I targave, mekanizimi , dëshmitë mbi pronësinë ose kontratë për huazim , foto etj )

### P4 -

Te gjeturat:

Oferta financiare(pershkrimi i cmimeve) e OE te propozuar per kontrate, nuk ndryshon nga ofertat financiare te OE tjere pjesmarres ne kete aktivitet te prokurimit, respektivisht ne gjithesejt 72 pozicione sa ka secili LOT, shumica e pozicioneve kan cmime jo-normalisht te uleta, ndersa pozicione te caktuara kan cmime jo normalisht te larta, mirepo permes formimit te cmimeve per pozicione, ateher vije deri te arsyeshmeria teknike-financiare.

Mare parasyshe kete, ateher AK ka qene obliguese qe te veproj konform:

*Neni 61 Tenderët Jo-Normalisht të Ulët*

dhe te kerkoj scarime per cmimet jonormalisht te uleta nga OE te propozuar per kontrate.

Cfardo veprimi tjetër nga AK konfirmon se AK ka vepruar ndesh me:

*Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi*

### OE i rekomanduar për Lot 3

#### P5-

OE i propozuar per kontrate ka dorezuar ANEKS 6 te plotesuar me tri kontrata dhe referencat respektive.

Dy kontrata e renditura me numrat rendor: 1 dhe 2, jane kontrata te periudhes kohore 2019-2020, gje qe jane te pavlefshme, ndersa vetem kontrata e renditur me numer rendor:3 e vitit 2022 eshte e vlefshme dhe ka vleren: 425,395.00€.

Sipas LPP kontratat dhe referencat jane te vlefshme vetem tri vitet e fundit nga data e njoftimit te aktivitetit te prokurimit, pra vitet: 2021, 2022 dhe 2023.

Komenti: OE i propozuar per kontrate nuk ka permbushur kerkesen e AK lidhur me  Kapaciteti teknik dhe professional, prandaj oferta si e tille eshte e papergjegjshme.

#### P6-

Te gjeturat:

OE i propozuar per kontrate ka autorizim nga dy prodhues te ndryshem: UNICOMLITE dhe DIECASTINGMANLIGHT.

OE i propozuar per kontrate ka ofertuar me dy prodhues per pozicionet e njejta,

#### P7-

Komenti: Mostra e dorezuar nuk disponon me te dhenat bazike te prodhuesit si dhe me te dhenat tjera te cilat do duhej te ishin konform te dhenave teknike te produktit te ofertuar me katalog.

Produkti ngjason me modelin e ofertuar YASL-09, mirepo te dhenat e produkti te vendosura ne stikser me ngjites ne mostren e produktit, nuk jane te ngjashme me te dhenat e produktit ne katalog (**ne katalog parametri i tensionit AC90-305V, ndersa ne stikser AC100-277V etj**), pervec tjerash, duket se stikseri i eshte vendosur mostres me te dhena sipas kerkeses se AK, respektivisht teksti ne gjuhen angleze eshte i shkruar gabim, gje qe e verteton nje gje te tille.

#### P8-

Vërejtje: OE duhet ta plotësoj kolonën D me te gjitha te dhënat për pajisjet e ofruara siç është (viti I prodhimit , gjendja e pajisjes , kamiona rexhistrimi i I targave, mekanizimi , dëshmitë mbi pronësinë ose kontratë për huazim , foto etj )

#### P9-

Oferta financiare(pershkrimi i cmimeve) e OE te propozuar per kontrate, nuk ndryshon nga ofertat financiare te OE tjere pjesmarres ne kete aktivitet te prokurimit, respektivisht ne gjithesejt 72 pozicione sa ka secili LOT, shumica e pozicioneve kan cmime jo-normalisht te uleta, ndersa pozicione te caktuara kan cmime jo normalisht te larta, mirepo permes formimit te cmimeve per pozicione, ateher vije deri te arsyeshmeria teknike-financiare.

## OE i rekomanduar për Lot 4

### P10-

Vërejtje: OE duhet ta plotësoj kolonën D me të gjitha të dhënat për pajisjet e ofruara siç është (viti I prodhimit , gjendja e pajisjes , kamiona rexhistrimi i I targave, mekanizimi , dëshmitë mbi pronësinë ose kontratë për huazim , foto etj )

### P11-

Te gjeturat:

Oferta financiare(pershkrimi i cmimeve) e OE te propzuar per kontrate, nuk ndryshon nga ofertat financiare te OE tjere pjesmarres ne kete aktivitet te prokurimit, respektivisht ne gjithesejt 72 pozicione sa ka secili LOT, shumica e pozicioneve kan cmime jo-normalisht te uleta, ndersa pozicione te caktuara kan cmime jo normalisht te larta, mirepo permes formimit te cmimeve per pozicione, ateher vije deri te arsyeshmeria teknike-financiare.

## Eliminimi i parashtruesit

### P12-

Prandaj AK ka qene obliguese te veproj konform Neni 61 Tenderët Jo-Normalisht të Ulët dhe te kerkoj scarime e nevojshme konform ketij neni, ashtu sic keni kerkuar scarime me dt.05.06.2024(*Tenderi juaj është vlerësuar me kujdes sipas kushteve dhe kriterëve të dhëna në Dosjen e tenderit dhe në Njoftimin për Kontrate. Në konsiderojmë që tenderi juaj është jo-normalisht i ulët për të gjitha lotet në krahasim me objektin e kontratës, andaj kerkojme që te sqaroni cmimin tuaj dhe formimin e tij per pozicionet nga 1.2.3.4.5 dhe 6 per te gjitha lote qe ju keni ofertuar*) ne vendimin e pare te dates: 14.06.2024 ku neve me te drejt jemi shpallur fitues nga ana e AK per LOT4 pasi qe kemi derguar scarimet adekuate rreth ekonomise se procesit.

### P13-

Nuk eshte permbushur kerkesa 7.3 lidhur me kapacitetin teknik dhe profesional ne DT. Mungone pese punonjes teknik me SSHP, CV, Kontrate dhe diploma. Vetem per 3 punonjes jane dorezuar dokumentet e kompletuara.

Komenti: Fillimisht kerkesa e AK nuk eshte per pese punonjes teknik ashtu sic pretendon AK, mirepo ashtu sic eshte kerkuar ne FDT po e citoj: *Kurse për LLOTOT 2, 3, dhe 4 kërkohet minimum 5 punëtor të cilët duhet të jenë të certifikuar për siguri në punë.*

### P14-

Vërejtje: OE duhet ta plotësoj kolonën D me të gjitha të dhënat për pajisjet e ofruara siç është (viti I prodhimit , gjendja e pajisjes , kamiona rexhistrimi i I targave, mekanizimi , dëshmitë mbi pronësinë ose kontratë për huazim , foto etj )

Pamvarsisht kesaj, AK nuk e ka pa te arsyeshme te kerkoj informacione shtese konform Neni 72 Dokumentacioni dhe informacioni shtesë, mirepo ka vepruar ne menyre diskriminuese duke na eliminuar nga konkurenca.



Lidhur me pretendimet ankimore fillimisht duhet sqaruar se sipas letrës standarde për tenderuesin e eliminuar, parashtruesi është shpallur si tenderues i papërgjegjshëm dhe është eliminuar nga aktiviteti i prokurimit për arsyet si në vijim:

**Tenderi juaj është refuzuar për këto arsye:**

Çmimi i ofertuar është jonormalisht i ulët sepse është dukshëm më i ulët sesa 30% nën mesataren e çmimit mesatar me të cilin kanë ofertuar tenderuesit OE në këtë AP si dukshëm më shumë sesa 10% nën çmimin e dytë më të lirë pas tij. Nuk është përmbushur kërkesa 7.3 lidhur me kapacitetin teknik dhe profesional në DT. Mungojnë pesë punonjës teknik me SSHP, CV, Kontratë dhe diploma. Vetëm për 3 punonjës janë dorëzuar dokumentet e kompletuara. Nuk është kërkesa e DT lidhur me pasijet dhe makineritë e kërkuara. Kjo sepse nuk kamioni me kran nuk është i regjistruar me librezë ndërsa kamioni me kiber nuk ka regjistrim.

**Sa i përket pretendimit ankimor nr. 12** – vlen të theksohet që shprehimisht as vet parashtruesi nuk e konteston faktin që çmimi me të cilin ka ofertuar është dukshëm më i ulët sesa 30% nën mesataren e çmimeve dhe dukshëm më i ulët sesa 10% nën çmimin e dytë më të lirë pas tij, prandaj çmimi i parashtruesit si i tillë është jonormalisht i ulët. Pra këto fakte nuk janë aspak kontestuese për parashtruesin. Pra që në shikim të parë (prima facie) çmimi i parashtruesit nuk duket i besueshëm nëse krahasohet me objektin e kontratës dhe në përputhje me rrethanat si dhe ka gjasa për një ndikim negativ në performancë gjatë implementimit të kontratës. Një vlerësim i tillë nga AK është në përputhje të plotë me nenin 41 par. 1 të RRPP ku përcaktohet se *“Koncepti i tenderit jonormalisht të ulët i referohet tenderëve që për autoritetin kontraktues në shikim të parë duken si jo të besueshëm nëse krahasohet me objektin e kontratës dhe në përputhje me rrethanat, dhe që ka gjasa për një ndikim negativ në performancë të implementimit të kontratës”*. Tutje përmes nenit 41 par. 3 të RRPP përcaktohet se çmimi jonormalisht i ulët ndër të tjera konsiderohet edhe atëherë kur *“çmimi i ofruar është më shumë se 30% më i ulët se çmimi mesatar i tenderëve të përgjegjshëm; çmimi i ofruar është më shumë se 10% më i ulët se çmimi ose kostot e tenderit të dytë më të ulët; janë dorëzuar të paktën 3 (tre) tenderë”*. Vlen të thuhet se AK para se të konfirmoj që çmimi i parashtruesit është jonormalisht i ulët, ka zhvilluar procedurë inter partes me parashtruesin ashtu që ka kërkuar sqarime shtesë në kuptim të nenit 41 par. 2 dhe 41 par. 6 të RRPP ku përcaktohet se *“Në rast se një tender (apo një pozicion i tenderit ku aplikohet çmimi i peshuar për njësi) duket të jetë jo normalisht i ulët, Autoriteti Kontraktues duhet të kërkoj me shkrim nga operatori ekonomik i cili ka dorëzuar tenderin ose pozicionin e tenderit që duket të jetë jo-normalisht i ulët sipas paragrafit 41.3 ose 41.4 të kësaj rregullore, një deklaratë me shkrim e cila përfshinë një zberthim të detajuar të pjesëve relevant të tenderit dhe e cila përfshinë një shpjegim për çmimin e ulët duke përdorur formularin standard të miratuar nga KRPP-ja Shkresa standarde për tenderët jo normalisht të ulët”*. Përndryshe as kjo pjesë nuk kontestohet nga parashtruesi pasi që në kërkesën për rishqyrtim konfirmohet që AK ka kërkuar sqarime për çmimin jonormalisht të ulët me datë 05.06.2024. Prandaj pretendimi ankimor si i tillë është i pabazuar në tërësi.

**Sa i përket pretendimeve nr. 13 dhe 14** – është analizuar me kujdes oferta e parashtruesit me ç’rast është gjetur se nuk është përmbushur kërkesa 7.3 lidhur me kapacitetin teknik dhe profesional në DT. Mungojnë 5 punonjës teknik me SSHP, CV, kontratë dhe diploma.

Vetëm për 3 punonjës janë dorëzuar dokumentet e kompletuara. Po ashtu nuk është plotësuar as kërkesa e DT lidhur me pajisjet dhe makineritë e kërkuara. Kjo sepse kamioni me kran nuk është i regjistruar me librezë ndërsa kamioni me kiper nuk ka regjistrim.

Sa i përket pretendimeve nr. 1 deri 11, fillimisht duhet cekur se të gjitha këto pretendime janë drejtuar kundër tenderuesve të tjerë, përderisa vet parashtruesi ka dorëzuar ofertë të papërgjegjshme. Përderisa parashtruesi vet ka dorëzuar ofertë të papërgjegjshme, i njëjti nuk mund të dëshmoj asnjë interes të vetëm material nga cilido rezultat i aktivitetit të prokurimit në raport me këto pretendime të tij ankimore të drejtuara kundër tenderuesve të tjerë. Përmes nenit 4 par. 1 nënpar. 26 të LPP përcaktohet se *“Palë e interesuar - personi që mund të dëshmojë interes material nga rezultati i aktivitetit të prokurimit të zbatuar nga autoriteti kontraktues në raport me një kontratë të veçantë publike ose konkurs projektimi duke përfshirë cilindo person i cili ka qenë ose mund të jetë në rrezik të dëmtimit nga një shkelje e pretenduar”*. Nga këndvështrimi i kësaj dispozite të LPP, përderisa parashtruesi për vete ka dorëzuar ofertë të papërgjegjshme për të cilën është eliminuar nga aktiviteti i prokurimit, dhe nuk ka arritur që të dëshmoj të kundërtën as me këtë kërkesë për rishqyrtim, atëherë i njëjti nuk është palë e interesuar në raport me pretendimet e tij ankimore kundër tenderuesve të tjerë.

Megjithatë duhet cekur se tenderuesit e rekomanduar për kontratë për lot 2, 3 dhe 4, secili prej tyre ka dorëzuar ofertë tërësisht të përgjegjshme dhe në përputhje të plotë me kërkesat e DT. Në fakt ofertat e tenderuesve të rekomanduar janë të vetmet oferta të përgjegjshme me çmimet më të lira. Prandaj rekomandimet për dhënie të kontratës nga komisioni vlerësues janë në përputhje të plotë me kriteret e dhënies së kontratës sipas dosjes së tenderit. Me fjalë të tjera, edhe po të ishte palë e interesuar parashtruesi në raport me këto pretendime, sërish pretendimet e tij janë në tërësi të pabazuara.

Në këtë mënyrë është gjetur se parashtruesi ka dorëzuar ofertë të papërgjegjshme për të cilën me të drejtë është eliminuar nga aktiviteti i prokurimit, ndërsa të gjitha pretendimet e tij ankimore janë të pabazuara në tërësi.

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. nënparagrafin b) lidhur me nenin 62 par. 62.1. nënparagrafin d) të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 05.09.2024

Visar SHEHU



Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit  
Komuna e Prishtinës

**Këshillë juridike:**

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.